



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, 14 dhe 17 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008 , Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164, Programit Komunal trevjeçar për banim 2016-2019 , dhe neneve 9 shkronja l) ,17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 02. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit miratoi:

### VENDIM

#### PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDARJEN E BANESAVE NË PRONËSI TË KOMUNËS SIPAS PROGRAMIT KOMUNAL TRE VJEQAR PËR BANIM 2016-2019

##### Neni 1

1.Me këtë Vendim fillon procedura për ndarjen e banesave në pronësi të Komunës konform dispozitave të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164, Programit Komunal trevjeçar për banim 2016-2019 i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.360-11818 i datës 04.03.2016.

2. Qëllimi i ndarjes së këtyre banesave është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për familjet të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

##### Neni 2

Banesat në pronësi të Komunës në pajtim me dispozitat ligjore do të ndahen sipas procedurave të Konkursit publik duke zbatuar legjislacionin në fuqi si vijon:

- Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164,
- Programit Komunal trevjeçar për banim 2016-2019,
- Udhëzimit administrativ nr.18/2010 për përmbajtjen kontratës për banesat me qira joprofitabile,
- Udhëzimi administrativ nr.14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për sugurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve , të zhdukurve të UÇK-së, për veteranët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarrët e tyre
- Udhëzimit Administrativ nr.19/2010 për përmbajtjen e Bonusit të Banimit,
- Udhëzimi Administrativ nr.21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit ,
- Udhëzimi Administrativ nr. 22/2010 Për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit,

- Udhëzimit Administrativ nr.23/2010 për Procedurat e Shpalljes të Programeve të Veçanta të Banimit,
- Udhëzimi Administrativ nr.24/2010 për Normat e Banimit për Programet e Veçanta të Banimit .

### Neni 3

Banesat në pronësi të Komunës do të ipen nëpërmjet qirasë joprofitabile. Përcaktimi i kufijve minimal dhe maksimal të të ardhurave të familjeve që mund të përfitojnë nga programi për banesat me qira, sipas strukturës së familjeve përcaktohet me formulën e cekur në nenin 6 të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164. Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit.

### Neni 4

Banesat e cekura, konform Programit komunal trevjeçar për banim do tu ndahen në familjeve të cilat aplikojnë në konkursin publik dhe të cilat i plotësojnë kriteret ligjore sipas legjislacionit të cekur në nenin 2 të këtij Vendimi.

### Neni 5

Banesat të cilat do të ndahen janë banesat me shënimet në tabelën në vijim:

Nr	Numri i njësis kadastrale	Adresa	Hyrja	Kati	Nr	Sipërfaqja
1.	O-71409044-01926-0-29-1-22-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	II	22	61.69 m <sup>2</sup>
2.	O-71409044-01926-0-29-1-3-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	II	3	74.79 m <sup>2</sup>
3.	O-71409044-01926-0-29-1-7-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	III	7	90 m <sup>2</sup>
4.	O-71409044-01926-0-29-1-8-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	III	8	75 m <sup>2</sup>
5.	0-71409044-01926-0-29-1-13-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	IV	13	75.35 m <sup>2</sup>
6.	O-71409044-01926-0-29-1-14-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	IV	14	49m <sup>2</sup>
7.	0-71409044-01926-0-29-1-17-0	rr.Lidhja e Prizrenit	1	V	17	89.46 m <sup>2</sup>
8.	0-71409044-01926-0-29-1-18-0	rr."Lidhja e Prizrenit"	1	V	18	75.82 m <sup>2</sup>
9.	0-71409044-01920-0-51-1-1-0	rr."Isa Olluri"	1	II	1	84.41 m <sup>2</sup>
10.	0-71409044-01920-0-51-1-5-0	rr."Isa Olluri"	1	II	5	64.52 m <sup>2</sup>
11.	O-71409044-01920-0-51-2-1-0	rr."Isa Olluri"	2	II	1	47.83 m <sup>2</sup>
12.	O-71409044-01920-0-51-2-2-0	rr."Isa Olluri"	2	II	1	103.32 m <sup>2</sup>
13.	O-71409044-01920-0-51-2-5-0	rr."Isa Olluri"	2	III	5	47.83m <sup>2</sup>
14.	O-71409044-01920-0-51-2-6-0	rr."Isa Olluri"	2	III	6	103.32 m <sup>2</sup>

15.	0-71409044-01920-0-51-2-8-0	rr."Isa Olluri"	2	III	8	125.9 m2
16.	0-71409044-01920-0-51-2-10-0	rr."Isa Olluri"	2	IV	10	103.32 m2
17.	0-71409044-01920-0-51-2-12-0	rr."Isa Olluri"	2	IV	12	125.9 m2
18.	0-71409044-01920-0-51-3-9-0	rr."Isa Olluri"	3	IV	9	65.25 m2
19.	0-71409044-01920-0-51-1-19-0	rr."Isa Olluri"	1	V	19	88.34 m2
20.	0-71409044-01920-0-51-2-13-0	rr."Isa Olluri"	2	V	13	47.83 m2
21.	0-71409044-01920-0-51-2-16-0	rr."Isa Olluri"	2	V	16	125.9 m2

### Neni 6

Obligohet Zyra e Kryetarit të Komunës në bashkëpunim me drejtoratet komunale përkatëse që më së largu brenda afatit 60 ditor nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi të SHPALL konkurs publik për aplikim sipas kritere të përcaktuara me legjislacionin në fuqi .

### Neni 7

Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të Konkursit publik, në pajtim me nenin 5 të Udhëzimit administrativ nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veqanta të banimit dhe Vendimit 15Nr.360-11818 për miratimin e programit komunal trevjeçar për banim 2016-2019 të datës 04.03.2016 të formojë Komisionin për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve i cili do të bëjë përzgjedhjen e familjeve konform dispozitave dhe kritereve të përcaktuar në legjislacionin e lartëcekur .

### Neni 8

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 360-12871  
Lipjan, më 01. 03. 2018

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT  
Daut Azemi

